



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ  
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR  
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 5388 Prot

Maliq, më 18.10.2022

LËNDA: Shpallje publike për Kreditë e Buta.

NJËSISË ADMINISTRATIVE STZMP

BASHKIA MALIQ

Në zbatim të ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr.384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga Shteti”, shkresës nr.407/53 datë 01.08.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Mbi zgjerimin e programit të subvencionit të interesave të kredisë për strehim”:

THIRRJE PËR APLIKIM  
KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI

Njoftojmë të gjithë të pa strehët e Bashkisë Maliq se kanë filluar aplikimet mbi programin e strehimit social të “Subvencionit të interesave të kredisë për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”.

Familjet të cilat kanë aplikuar para daljes së këtij njoftimi, duhet të kryejnë rifreskimin e aplikimit, në përputhje me kërkesat për dokumentacion që duhet të përmbajë dosja e aplikantit.

“Kredi me kushte lehtësuese” është kredia/huaja, interesat e së cilës subvencionohen nga institucionet shtetërore. Financimi nga buxheti i shtetit dhe/ose i njëjve të vetëqeverisjes vendore jepet në formën e subvencionimit të interesave të kredisë për ato familje, të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë dot pagesat e kredisë për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhe se mesatarja e vlerave të tregut në atë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit.

Ky program synon të mbështesë në blerjen e banesave në treg të lirë, brenda territorit të bashkisë Maliq, familjet të cilat nuk kanë një strehim të përshtatshëm dhe me të ardhurat e tyre mund të përballojnë koston e kredisë me kushte lehtësuese.

Të gjithë të interesuarit janë të lutur të paraqiten për të marrë informacion dhe për të dorëzuar kërkesën së bashku me dokumentacionin e nevojshëm pranë Zyrës së Strehimit Bashkia Maliq.

KRYETARI I BASHKISË  
Gëzim TOPCIU

Nr. 108 Prot

Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

www.bashkiamaliq.gov.al

Dt. 18.10.2022

**Kriteret që duhet të plotësojnë familjet** sipas ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr.384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituruar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga Shteti”, janë si më poshtë :

- **Përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët** me kredi të lehtësuara nga shteti, familjet me të ardhura mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, sipas përcaktimit të nenit 2, pika 45, shkronja “a”, ligjit 22/2018 “Për strehimin social”, të cilat, në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore:
  - a) vërtetojnë se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekje apo sëmundje e rëndë) ose force madhore;
  - b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;
  - c) janë të zhvendosura nga banesat, sipas parashikimeve në nenin 6 të ligjit 22/2018 “Për strehimin social”.
- **Niveli maksimal i të ardhurave** neto në lekë sipas madhësisë së familjes përfituese nuk duhet të jetë më i lartë se 120% të të ardhurave mesatare, bazuar ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social” i pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Përbërja familjare	Të ardhurat mesatare në lekë	Të ardhurat maksimale (120% të të ardhurave mesatare) në lekë
1 person	42,252	50,702.4
2 persona	64,358	77,229.6
3 persona	87,203	104,644
4 persona	92,572	111,086
5+ persona	11,1870	134,244

Niveli maksimal i të ardhurave të familjeve, sipas strukturës së apartamentit që ato përfitojnë, i referohet nenit 2, pika 45, germa ‘a’ e ligjit nr. 22/2018 Për strehimin social”.

Të dhënat e përditësuara mbi nivelin mesatar të konsumit, sipas strukturave familjare merren nga INSTAT.

“Të ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuara, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihen të ardhura nga ndihma ekonomike, pagesat e papunësisë, përfitimet e personave me aftësi të kufizuara, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, nga ndihma ekonomike për shkak të aftësisë së kufizuara, e parashikuar në ligjin nr. 9355 datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8098 datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 8626 datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik”; nga rimbursimi i shpenzimeve për energji elektrike; nga rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe nga paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara. Të ardhurat e deklaruara duhet të jenë të faktuara me dokumentacion ligjor që njihen nga sistemi tatimor i shtetit Shqiptar dhe të mjaftueshme për të përballuar koston e kredisë.

- **Kufiri maksimal i kredisë** për familjet që do të përfitojnë kredi të buta të subvencionuara nga shteti është:

Nr	Struktura e familjes/persona	Struktura e apartamentit	Kufiri maksimal i kredisë /Familje
1	1-2	G	1,668,000
2	3	1+1	2,001,600
3	4	2+1	2,335,200
4	5-6	3+1	2,835,600

Kontrata e kredisë që do të lidhë qytetari do të jetë me interes fiks për pjesën që i takon qytetarit deri në 3%, ndërsa luhatjet mbi këtë normë interesi janë në ngarkim të buxhetit të shtetit.

Kohëzgjatja e kredisë është në vartësi të moshës së aplikantit dhe përcaktohet rast pas rasti nga Banka por jo më shumë se 360 muaj.

Material Informues Kushtet e kreditimit:

- Monedha e kreditimit: Lek;
- Afati maksimal i kredisë: 360 muaj;
- Norma e interesit: jo më shumë se 3%;
- Shuma e kredisë në raport me vlerën e banesës:
  - 80% - 85% në varësi të kushteve të bankës
- Lloji i kolateralit të pranuar: pasuria e patundshme që do blihet.

➤ **Kufizimet**

1. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t'i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë te një individ tjetër ose ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë.
2. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët dhe e ka shlyer kredinë, duke u bërë pronare e saj, në rast tjetërsimi të banesës humbet të drejtën për të përfituar nga programet e strehimit për një periudhë 10-vjeçare, me përjashtim kur e tjetëron banesën për arsye madhore, si vdekje apo sëmundje e rëndë.
3. Nëse, për arsye madhore, si vdekje apo sëmundje e rëndë, familja që ka përfituar banesë me kosto të ulët e tjetëron atë, i lind e drejta për të aplikuar në një nga programet e strehimit.

**Dosja e aplikantit** duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

**a) Formulari i Aplikimit.**

**b) Për të dhënat personale të aplikantit:**

- i) Fotokopje Kartë Identiteti;
- ii) certifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;
- iii) vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.

**c) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":**

- i) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen (në pronësi apo proces legalizimi) në emër të secilit anëtar të familjes;
- ii) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës,

që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi;

- iii) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- iv) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit;
- v) aktverifikim nga njësia vendore për:
  - banesat në rrezik shembjeje;
  - rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
  - banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit.
- vi) Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;
- vii) akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.
- viii) Vërtetim prone (formulari 01 dhe formulari 06) nga njësia Administrative i shoqëruar Çertifikatë familjare të 1991.

**d) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës “b”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:**

- i) certifikatë familjare;
- ii) vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

**e) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës “c”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:**

- i) vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;
- ii) vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;
- iii) dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;
- iv) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;
- v) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;
- vi) urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;
- vii) vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;
- viii) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- ix) vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
- x) vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë.

**f) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës “ç”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:**

- i) vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi

për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

- ii) dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- iii) vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- iv) vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë si dhe ata të rregjistruar si punëkërkuar të pa punë;
- v) vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.
- vi) vërtetim nga organet tatimore, që nuk është i rregjistruar pranë organeve tatimore, për të gjithë anëtarët e familjes (vërtetim për individ të pa rregjistruar).

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Gëzim TOPCIU**

